

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËRKESEPADI

Me kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë

PADITËS:

GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
përfaqësuar me autorizim nga Anila Kulo, Kancelare e Gjykatës
së Lartë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të institucionit.

TË PADITUR:

1. **MINISTRIA E FINANCIVE**, Tiranë.
2. **DEGA E THESARIT TIRANË**, pranë Ministrisë së Financave.

PERSON I TRETË:

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, Tiranë.

OBJEKTI I PADISË:

1. Konstatimi i paligjshmërisë dhe, për rrjedhojë, shfuqizimin e aktit/veprimit administrativ të Ministrisë së Financave, të materializuar në shkresën nr. 14110, datë 2.09.2026, si dhe në komunikimet/udhëzimet pasuese drejtuar strukturave të Thesarit, në pjesën që kanë penguar procedimin dhe ekzekutimin e urdhër-shpenzimeve dhe listëpagesave të Gjykatës së Lartë, të hartuara në zbatim të vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Urdhrit nr. 240, datë 31.08.2026 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.
2. Konstatimi i paligjshmërisë dhe, për rrjedhojë, shfuqizimin e akteve dhe/ose veprimeve administrative të Degës së Thesarit Tiranë, të materializuara në refuzimin, mosprocedimin ose pezullimin e ekzekutimit të urdhër-shpenzimeve dhe listëpagesave të paraqitura nga Gjykata e Lartë për muajin gusht 2026.
3. Detyrimi i palëve të paditura të kryejnë veprimet administrative që u përkasin sipas ligjit, duke proceduar dhe ekzekutuar urdhër-shpenzimet dhe listëpagesat e paraqitura nga Gjykata e Lartë, sipas përlllogaritjes së pagave të kryer në zbatim të vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Urdhrit nr. 240, datë 31.08.2026 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.
4. Detyrimi i palëve të paditura që të mos kushtëzojnë procedimin dhe ekzekutimin e dokumentacionit financiar të Gjykatës së Lartë me ripërlllogaritjen e pagave sipas parametrave të muajit korrik 2026, për sa kohë vendimi nr. 435, datë 26.08.2026 i KLGJ-së dhe Urdhri nr. 240, datë 31.08.2026

i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, janë në fuqi dhe prodhojnë efektet e tyre juridike.

4. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur, deri në përfundimin e gjykimit me vendim të formës së prerë:

a) pezullimin e efekteve të aktit/veprimit administrativ të Ministrisë së Financave, të materializuar në shkresën nr. 14110, datë 2.09.2026, si dhe të veprimeve administrative pasuese të strukturave të Thesarit, në pjesën që kanë sjellë mosprocedimin, pezullimin ose pengimin e urdhër-shpenzimeve dhe listëpagesave të paraqitura nga Gjykata e Lartë;

b) si masë tjetër të përshtatshme, urdhërimin e menjëhershëm të palëve të paditura që, gjatë kohëzgjatjes së masës së sigurimit, të mos pengojnë dhe të mos mbajnë të pezulluar procesimin në sistemin e Thesarit të urdhër-shpenzimeve dhe listëpagesave të paraqitura nga Gjykata e Lartë në zbatim të vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Urdhrit nr. 240, datë 31.08.2026 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 7, 42, 132, 138 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, veçanërisht nenet 2, 15, 17, 18 dhe 28-30; ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; vendimi nr. 15, datë 17.02.2026 i Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 435, datë 26.08.2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor; Urdhri nr. 240, datë 31.08.2026 i Kryetarit të Gjykatës së Lartë; si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme.

DREJTUAR:

GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Vendimi nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15, datë 17.02.2026, ka shqyrtuar rregullimin ligjor të pagës së magistratëve dhe ka përcaktuar standardet kushtetuese që duhet të respektohen për pagën referuese të tyre. Ajo ka përcaktuar gjithashtu afatin brenda të cilit ligjvënësi duhej të ndërhynte dhe momentin nga i cili prodhoheshin efektet e shfuqizimit të rregullimit të kundërshtuar. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 132 të Kushtetutës, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

Në kushtet kur afati i përcaktuar në vendimin kushtetues kishte përfunduar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore për administrimin e sistemit gjyqësor dhe statusin financiar të magistratëve, procedoi me zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

2. Vendimi nr. 435, datë 26.08.2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Në zbatim të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimin nr. 435, datë 26.08.2026, “Mbi miratimin e pagës referuese bazë të magistratit (gjyqtar), sipas vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese”.

Me këtë vendim u konkretizua, për sistemin gjyqësor, paga referuese bazë e magistratit dhe efektet financiare që rrjedhin prej saj. Ky akt është në fuqi. Ai nuk rezulton të jetë shfuqizuar, pezulluar apo deklaruar i pavlefshëm nga ndonjë organ kompetent dhe as të jetë kërkuar kundërshtimi i tij në rrugë gjyqësore, nga ndonjë autoritet publik.

Për rrjedhojë, organet dhe strukturat e sistemit gjyqësor kanë jo vetëm të drejtën, por detyrimin për ta zbatuar atë.

3. Urdhri nr. 240, datë 31.08.2026 i Kryetarit të Gjykatës së Lartë

Në zbatim të vendimit nr. 435/2026 të KLGJ-së, Kryetari i Gjykatës së Lartë nxori Urdhrin nr. 240, datë 31.08.2026, “Për përlllogaritjen dhe përfitimin e pagës referuese bazë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor”.

Në këtë urdhër është përcaktuar se, duke filluar nga data 01.08.2026, paga referuese bazë e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë përlllogaritet sipas standardeve kushtetuese të konkretizuara nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. 435/2026 i KLGJ-së.

Urdhri ka përcaktuar pagën referuese bazë në shumën **236.425 lekë**, të përbërë nga paga për pozicionin dhe shtesa për nivelin e kualifikimit, si dhe ka urdhëruar përlllogaritjen e efekteve financiare përkatëse. Struktura përgjegjëse për financën në Gjykatën e Lartë është ngarkuar me zbatimin e urdhrit, përlllogaritjen e pagave dhe kryerjen e veprimeve financiare përkatëse. Urdhri ka hyrë në fuqi menjëherë, me efekte nga data 01.08.2026.

Pra, përpara paraqitjes së dokumentacionit financiar pranë Thesarit, Gjykata e Lartë kishte kryer të gjitha veprimet institucionale që i përkisnin kompetencës së saj.

4. Përgatitja dhe paraqitja e urdhër-shpenzimeve

Në zbatim të Urdhrit nr. 240/2026, struktura financiare e Gjykatës së Lartë përlllogariti pagat dhe përgatiti dokumentacionin financiar për muajin gusht 2026.

Më datë 01.09.2026 u hartuan dhe u paraqitën për procedim pranë Degës së Thesarit Tiranë urdhër-shpenzimet nr. 312, 313, 314, 315, 316, 317, 318 dhe 319, të shoqëruara me listëpagesat dhe dokumentacionin bankar përkatës. Urdhër-shpenzimet nr. 312–314 dokumentojnë fazën e parë të këtij procesi financiar. Po kështu, urdhër-shpenzimet nr. 315–318 dokumentojnë vijimin e të njëjtës procedurë financiare për pagesat e muajit gusht. Seria plotësohet me urdhër-shpenzimin nr. 319, datë 01.09.2026.

Kështu, Gjykata e Lartë ka përmbushur zinxhirin e veprimeve që i përkisnin kompetencës së saj financiare. Pra, ka një akt të KLGJ-së në fuqi, një urdhër institucional për zbatimin e tij, përlllogaritjen konkrete, listëpagesat, urdhër-shpenzimet dhe paraqitjen e dokumentacionit për procedim në sistemin e Thesarit.

5. Ndërhyrja e Ministrisë së Financave

Pas paraqitjes së dokumentacionit financiar, Ministria e Financave ndërhyri lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së pagave. Në shkresën drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministri i Financave pranon se në sistemin e Thesarit ishin paraqitur listëpagesa dhe urdhër-shpenzime të muajit gusht 2026 me një pagë referuese të ndryshme nga ajo e përdorur deri në muajin korrik 2026.

Ministria deklaron se strukturat e Thesarit nuk kanë kompetencë të zgjedhin ndërmjet interpretimeve të ndryshme të vendimit kushtetues dhe as të trajtojnë, pa një bazë ligjore të qartë, aktet e autoriteteve të pavarura të gjyqësorit si zëvendësuese të rregullimit ligjor.

Megjithatë, pikërisht mbi këtë premisë, Ministria sugjeron që KLGJ-ja dhe KLP-ja të marrin masa që listëpagesat dhe urdhër-shpenzimet e muajit gusht 2026 të paraqiten përsëri në Thesar **sipas parametrave të përdorur në muajin korrik 2026**, duke deklaruar se vetëm pas këtij veprimi strukturat e Thesarit do të procedonin me përparësi pagesat.

Në këtë mënyrë, pavarësisht përdorimit formal të termit “sugjerojmë”, përmbajtja dhe pasojat e shkresës nuk mbetën në nivelin e një opinionit juridik. Ajo prodhoi efekt administrativ konkret: dokumentacioni i hartuar sipas vendimit nr. 435/2026 të KLGJ-së dhe Urdhrit nr. 240/2026 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë nuk u procedua.

6. Refuzimi i strukturave të Thesarit

Kjo lidhje shkakësore konfirmohet nga komunikimet zyrtare të punonjësve të Thesarit. Në këto komunikime është bërë e ditur se: “*në vijim të komunikimit me Ministrinë e Financave*”, Dega e Thesarit nuk mund të procedonte me ekzekutimin e diferencave të pagave deri në përfundimin e verifikimit.

Pra, mosprocedimi nuk ishte rezultat i mungesës së dokumentacionit financiar të Gjykatës së Lartë. Ai ishte rezultat i drejtpërdrejtë i qëndrimit të mbajtur nga Ministria e Financave.

II. LEGJITIMIMI AKTIV I GJYKATËS SË LARTË

Gjykata e Lartë legjitimohet në ngritjen e kësaj padie, jo si përfaqësuese individuale e gjyqtarëve apo e punonjësve të saj, por si institucion publik, të cilit veprimet administrative të kundërshtuara i kanë cenuar drejtpërdrejt ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrimeve të veta ligjore dhe financiare. Gjykata e Lartë, nëpërmjet strukturave kompetente dhe Nëpunësit Autorizues, ka detyrimin ligjor të administrojë fondet e veta buxhetore, të përlllogarisë pagat dhe të realizojë pagesën e gjyqtarëve dhe personelit të saj.

Në lidhje me ushtrimin e kompetencave financiare, me autorizimin nr. 1243/1 prot., datë 23.03.2022, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 9 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenin 19 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore përkatëse, ka autorizuar znj. Anila Kulo, Kancelare e Gjykatës së Lartë, të ushtrojë të gjitha kompetencat e Nëpunësit Autorizues, duke filluar nga data 23.03.2022 deri në revokimin e autorizimit. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 1755/2 prot., datë 29.03.2022, ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për caktimin e saj si Nëpunës Autorizues i deleguar, ndërsa me shkresën nr. 1755/2 prot., datë 28.03.2022, ka njoftuar Gjykatën e Lartë për vijimin e procedurave të njohjes së firmës pranë Degës së Thesarit Tiranë. Për rrjedhojë, kompetenca e nëpunësit autorizues dhe njohja e saj nga strukturat financiare e të Thesarit janë të dokumentuara zyrtarisht.

Veprimi i palëve të paditura e ka vendosur institucionin në pamundësi për të ekzekutuar urdhër-shpenzimet e nxjerra rregullisht dhe, për rrjedhojë, për të përmbushur detyrimet e veta ligjore ndaj personelit. Për këtë arsye ekziston një interes institucional, aktual, i drejtpërdrejtë dhe i ligjshëm për kundërshtimin gjyqësor të veprimeve administrative që kanë shkaktuar këtë pengesë.

III. NATYRA JURIDIKE E VEPRIMEVE TË KUNDËRSHTUARA

Paligjshmëria e kundërshtuar nuk mund të shmanget përmes emërimit formal të shkresës së Ministrisë si “sugjerim” ose të veprimit të Thesarit si “verifikim”. Natyra juridike e një veprimi administrativ përcaktohet nga përmbajtja dhe efektet juridike që ai prodhon.

Në rastin konkret ekziston një zinxhir i qartë: **vendimi nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese - vendimi nr. 435/2026 i KLGJ-së - Urdhri nr. 240/2026 i Kryetarit të GJL-së - përlllogaritja dhe urdhër-shpenzimet - ndërhyrja e Ministrisë së Financave - refuzimi/mosprocedimi nga Thesari - mosrealizimi i efekteve financiare.**

Për këtë arsye, edhe nëse gjykata do të vlerësonte se shkresa e Ministrisë nuk përmbush elementet formale të një akti administrativ individual, ajo përbën të paktën një **veprim tjetër administrativ me pasoja juridike konkrete**, i kontrollueshëm nga gjykata administrative sipas ligjit nr. 49/2012.

IV. SHKAQET E PALIGJSHMËRISË

1. Organet e pushtetit gjyqësor kanë zbatuar vendimin nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese

Premisa themelore e kësaj padie është se KLGJ-ja dhe Gjykata e Lartë nuk kanë krijuar një regjim të ri page sipas vullnetit të tyre. Ato kanë **zbatuar vendimin përfundimtar dhe detyrues nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese**.

KLGG-ja, si organi kushtetues i qeverisjes së sistemit gjyqësor, e konkretizoi këtë zbatim me vendimin nr. 435/2026.

Kryetari i Gjykatës së Lartë, në ushtrim të përgjegjësiave institucionale dhe financiare, zbatoi vendimin e KLGJ-së nëpërmjet Urdhrit nr. 240/2026.

Prandaj, përlllogaritja e pagave dhe urdhër-shpenzimet e paraqitura në Thesar janë **pasoja financiare të zbatimit të një zinxhiri aktesh juridike në fuqi**.

2. Organet financiare kanë penguar prodhimin e efekteve juridike të këtyre akteve

Ministria e Financave dhe strukturat e Thesarit nuk kanë shfuqizuar formalisht vendimin e KLGJ-së dhe as Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe as kanë ndërmarrë ndonjë nismë për kundërshtimin e këtyre akteve në rrugë gjyqësore. Ato kanë bërë diçka që prodhon praktikisht të njëjtin rezultat: **kanë penguar zbatimin e tyre financiar**.

Një akt administrativ në fuqi nuk mund të neutralizohet faktikisht nga një organ tjetër publik vetëm sepse ky i fundit mban një interpretim të ndryshëm për bazën juridike të tij. Për sa kohë akti nuk është shfuqizuar, anuluar ose pezulluar sipas procedurave të parashikuara nga ligji, ai prodhon efektet juridike që i përkasin.

3. Tejkalimi i kompetencës së kontrollit financiar

Paditësi nuk mohon kompetencën e strukturave të Thesarit për kontrollin e rregullsisë dhe ligjshmërisë financiare të dokumentacionit që u paraqitet. Megjithatë, kjo kompetencë ka kufij.

Kontrolli financiar nuk mund të shndërrohet në kompetencë për:

- interpretimin përfundimtar të vendimit të Gjykatës Kushtetuese;
- rivlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të KLGJ-së;
- pezullimin faktik të efekteve të tij;
- ose detyrimin e një organi të pushtetit gjyqësor që të mos zbatojë një akt në fuqi.

Në të kundërt, kontrolli financiar do të shndërrohej në kontroll administrativ të pushtetit ekzekutiv mbi vendimmarrjen e organeve kushtetuese të qeverisjes së gjyqësorit dhe në cenim të pavarësisë së gjyqësorit.

4. Kontradikta e qëndrimit të Ministrisë së Financave

Ministria deklaron në shkresën e saj se verifikimi nuk ka për objekt bllokimin e pagave, por pasoja faktike dhe juridike e veprimit është pikërisht mosprocedimi i dokumentacionit dhe mosrealizimi i pagesave.

Gjithashtu, nga njëra anë Ministria pohon se Thesari nuk mund të zgjedhë ndërmjet interpretimeve të vendimit kushtetues, ndërsa nga ana tjetër kërkon që përlllogaritja e muajit gusht të rikthehet te parametrat e muajit korrik. Kjo do të thotë se, në praktikë, është zgjedhur njëri prej interpretimeve dhe është kushtëzuar ekzekutimi financiar me pranimin e tij nga organet e gjyqësorit.

5. Cenimi i pavarësisë dhe autonomisë financiare të gjyqësorit

Çështja nuk reduktohet në një mosmarrëveshje teknike për përlllogaritjen e një page. Paga e gjyqtarit përbën një nga garancitë institucionale të pavarësisë së tij.

Në rastin konkret, organi kushtetues kompetent i qeverisjes së gjyqësorit ka përcaktuar mënyrën e zbatimit të vendimit kushtetues, ndërsa Gjykata e Lartë ka kryer veprimet financiare për zbatimin e tij. Ndërhyrja e pushtetit ekzekutiv që pengon prodhimin e efekteve financiare të këtyre akteve prek, për këtë arsye, jo vetëm një marrëdhënie financiare, por raportin kushtetues ndërmjet pushteteve.

Gjykata e Lartë nuk po kërkon që t'i njihet një privilegj financiar dhe as po përcakton vetë pagat e gjyqtarëve të saj. Ajo kërkon **zbatimin e një vendimi të KLGJ-së të nxjerrë në zbatim të një vendimi përfundimtar dhe detyrues të Gjykatës Kushtetuese.**

V. KËRKESA PËR SIGURIMIN E PADISË

Në mbështetje të neneve 28-30 të ligjit nr. 49/2012, kërkojmë marrjen e masës së sigurimit të padisë. Ligji parashikon sigurimin kur, gjatë kohës së nevojshme për gjykimin e themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm nga veprimi administrativ. Neni 29 kërkon dyshim të arsyeshëm të bazuar në shkresa për një dëm të rëndë, të pakthyeshëm e të atëçastshëm dhe që masa të mos cenojë rëndë interesin publik. Neni 30 lejon pezullimin e aktit ose veprimit administrativ dhe, kur kjo nuk mjafton, marrjen e masave të tjera të përshtatshme.

KËRKOJMË:

Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur, deri në përfundimin e gjykimit me vendim të formës së prerë:

a) pezullimin e efekteve të aktit/veprimit administrativ të Ministrisë së Financave, të materializuar në shkresën nr. 14110, datë 2.09.2026, si dhe të veprimeve administrative pasuese të strukturave të Thesarit, në pjesën që kanë sjellë

mosprocedimin, pezullimin ose pengimin e urdhër-shpenzimeve dhe listëpagesave të paraqitura nga Gjykata e Lartë;

b) si masë tjetër të përshtatshme, urdhërimit e palëve të paditura që, gjatë kohëzgjatjes së masës së sigurimit, të mos pengojnë dhe të mos mbajnë të pezulluar procesimin në sistemin e Thesarit të urdhër-shpenzimeve dhe listëpagesave të paraqitura nga Gjykata e Lartë në zbatim të vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Urdhrit nr. 240, datë 31.08.2026 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Argumentet ligjore në mbështetje të kërimit për sigurimin e padisë:

1. Ekziston rreziku i një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm

Dëmi nuk konsiston vetëm në krijimin e një detyrimi monetar që teorikisht mund të shlyhet në të ardhmen. Mosrealizimi i pagesave prek në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e një organi të pushtetit gjyqësor, gjyqtarët dhe personelin që mundëson ushtrimin e funksionit të tij.

Gjykata e Lartë ka kryer veprimet financiare që ligji i ngarkon, por është vendosur në pamundësi për të përmbushur detyrimin e saj për pagesën e magjistratëve dhe personelit, për shkak të një pengese që buron jashtë institucionit. Një pengesë e tillë ka krijuar një dëm real e të pakthyeshëm në raport me të drejtën e pagës, si një nga elementët themelorë të pavarësisë gjyqësore dhe statusit të magjistratit dhe si një nga elementët themelorë të marrëdhënies së punës të personelit të Gjykatës së Lartë. Mos marrja e pagës ekspozon magjistratët dhe personelin e Gjykatës së Lartë përpara pamundësisë së përmbushjes në normalitetet të detyrave të tyre si dhe kushtëzon përmbushjen e nevojave të tyre jetësore.

Dëmi jo vetëm që është aktual dhe tashmë ka sjellë pasoja reale në raport me të drejtën e Magjistratëve dhe të personelit të Gjykatës së Lartë për të përfituar pagën e muajit gusht 2026, por edhe është vijues, për sa kohë që pengesa administrative vazhdon.

2. Provat janë shkresore dhe të drejtpërdrejta

Kushti i nenit 29 të ligjit nr. 49/2012 plotësohet nëpërmjet vetë dokumentacionit të paraqitur: vendimit të KLGJ-së, Urdhrit nr. 240/2026, urdhër-shpenzimeve nr. 312-319, shkresës së Ministrisë së Financave dhe komunikimeve zyrtare të strukturave të Thesarit (të cilat janë të bashkëlidhura në këtë kërkesëpadi).

Nuk kemi të bëjmë me një rrezik hipotetik. Mosprocedimi është materializuar tashmë.

3. Masa nuk cenon interesin publik

Marrja e masës nuk krijon një shpenzim të ri dhe as një detyrim financiar të vendosur për herë të parë nga Gjykata e Lartë. Ajo synon të shmangë që një mosmarrëveshje ndërinstitucionale të paralizojë realizimin e detyrimeve financiare të një organi të pushtetit gjyqësor.

Interesi publik qëndron në funksionimin e rregullt dhe të pandërprerë të Gjykatës së Lartë dhe në respektimin e procedurave ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve publike, jo në neutralizimin faktik të një akti në fuqi përmes mosprocedimit financiar.

4. Masa e kërkuar nuk paragjykon themelin

Paditësi mban në konsideratë standardin e vendosur nga vendimi unifikues nr. 10, datë 24.03.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas këtij standardi, gjykata, gjatë shqyrtimit të sigurimit të padisë, nuk duhet të nxjerrë përfundime që i përkasin zgjidhjes së çështjes në themel dhe duhet të shmangë çdo perceptim se e ka paravendosur atë. Po kështu, masa e sigurimit nuk mund të jetë e njëjtë me urdhërimin përfundimtar që paditësi kërkon nëpërmjet padisë.

Kërkesa për masë sigurimi e paraqitur në këtë çështje respekton këtë standard.

Me masën e sigurimit **nuk kërkohet nga gjykata të deklarojë përfundimisht se cila është masa e pagës së magjistratit dhe as të zgjidhë përfundimisht ligjshmërinë e qëndrimit të Ministrisë së Financave**. Kërkohet vetëm neutralizimi i përkohshëm i efektit bllokues të veprimeve administrative të kundërshtuara, në mënyrë që gjykimi në themel të mbetet efektiv.

Vetë vendimi unifikues ka njohur se “masat e tjera të përshtatshme” përcaktohen sipas natyrës së marrëdhënies dhe ka pranuar rëndësinë e vazhdimësisë në marrëdhënie ku ndërprerja mund të shkaktojë pasoja të pariparueshme. Për më tepër, vendimi unifikues ka dalluar shprehimisht pezullimin e një veprimi administrativ nga sigurimi klasik i një padie civile.

Ky dallim është sot i materializuar shprehimisht në nenet 28-30 të ligjit të posaçëm nr. 49/2012, i cili nuk ishte në fuqi në kohën e marrjes së vendimit unifikues. Janë pikërisht këto dispozita të ligjit të posaçëm që parashikojnë kushtet dhe kriteret për vendosjen e masës së sigurimit të padisë në gjykimin administrativ, duke ligjëruar si një nga llojet e masave të sigurimit pikërisht pezullimin e aktit apo veprimi tjetër administrativ. Një parashikim i tillë, dëshmon vullnetin e legjislatorit për diferencimin e natyrës së kërimit për kundërshtimin e ligjshmërisë së aktit apo veprimit tjetër administrativ, nga kërkitimi i një padie civile, e cila mund të ketë në themel kundërshtimin e një veprimi juridik. Në rastin konkret, nisur nga natyra e aktit/veprimit tjetër administrativ që kundërshtohet dhe menjëhershëmëria e pasojave të ardhura prej tij, legjitimohet sigurimi i padisë nëpërmjet pezullimit të efekteve të aktit/veprimit tjetër administrativ si dhe marrjen e masave të tjera të përshtatshme, duke mos përbërë ky një kërkitim të njëjtë me atë të kërkuar nëpërmjet padisë, ku në themel kundërshtohet ligjshmëria e aktit/veprimit tjetër administrativ.

Nëse gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit lejohet që veprimi i kundërshtuar të vazhdojë të prodhojë efektin e tij bllokues, vendimi përfundimtar, edhe në rast të pranimit të padisë, do të vinte pasi dëmi është konsumuar dhe ka vijuar në mënyrë të përsëritur gjatë gjithë periudhës së gjykimimit.

Pa mbrojtje të përkohshme, mbrojtja gjyqësore në këtë rast rrezikon të humbasë efektivitetin e saj praktik.

VI. PËRFUNDIM

Në rastin konkret nuk kemi përballë dy organe publike që kanë kompetencë të barabartë për të përcaktuar pagën e magjistratëve. Gjykata Kushtetuese ka dhënë vendimin nr. 15/2026. Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka zbatuar atë me vendimin nr. 435/2026. Gjykata e Lartë e ka zbatuar vendimin e KLGJ-së me Urdhrin nr. 240/2026. Struktura financiare e Gjykatës së Lartë ka materializuar zbatimin e këtyre akteve në listëpagesa dhe urdhër-shpenzime dhe i ka paraqitur ato në Thesar. Pikërisht në këtë hallkë ka ndërhyrë pushteti ekzekutiv dhe ka penguar prodhimin e efekteve juridike dhe financiare të akteve të mësipërme.

Kontrolli financiar i ligjshmërisë së shpenzimit publik është një funksion i ligjshëm dhe i domosdoshëm, por ai nuk mund të shndërrohet në një mekanizëm përmes të cilit një organ i pushtetit ekzekutiv pezullon faktikisht, rivlerëson ose neutralizon një akt në fuqi të organit kushtetues të qeverisjes së gjyqësorit dhe aktin e nxjerrë për zbatimin e tij nga Gjykata e Lartë.

Nëse organet financiare vlerësonin se aktet mbi të cilat mbështetej shpenzimi ishin të paligjshme, duhej të vepronin vetëm nëpërmjet mekanizmave dhe procedurave që ligji u njeh.

Mosprocedimi i pagesës nuk mund të shërbejë si mjet juridik për pezullimin faktik të një akti administrativ në fuqi.

Për këto arsye, kërkojmë pranimin e padisë sipas objektit të saj dhe marrjen me përparësi të masës së sigurimit të kërkuar.

VII. PROVAT

Në mbështetje të padisë dhe kërkesës për sigurimin e saj paraqiten:

1. Vendimi nr. 15, datë 17.02.2026 i Gjykatës Kushtetuese;
2. Vendimi nr. 435, datë 26.08.2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
3. Urdhri nr. 240, datë 31.08.2026 i Kryetarit të Gjykatës së Lartë;
4. Urdhër-shpenzimi nr. 312, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
5. Urdhër-shpenzimi nr. 313, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
6. Urdhër-shpenzimi nr. 314, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
7. Urdhër-shpenzimi nr. 315, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
8. Urdhër-shpenzimi nr. 316, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
9. Urdhër-shpenzimi nr. 317, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
10. Urdhër-shpenzimi nr. 318, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
11. Urdhër-shpenzimi nr. 319, datë 01.09.2026, me dokumentacionin bashkëlidhur;
12. Shkresa nr. 14110, datë 02.09.2026 e Ministrisë së Financave;
13. Autorizimi nr. 1243/1 prot., datë 23.03.2022, "Autorizim për kryerjen e detyrave të Nëpunësit Autorizues";
14. Shkresa e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 1755/2 prot., datë 28.03.2022, "Njoftim mbi vijimin e procedurave të njohjes së firmës në degën e thesarit për Nëpunësin Autorizues";

15. Komunikimet elektronike zyrtare të strukturave të Thesarit për mosprocedimin e diferencave të pagave;
16. Korrespondenca e Gjykatës së Lartë me Ministrinë e Financave, KLGJ-në dhe strukturat e Thesarit;
17. Çdo dokument tjetër financiar dhe administrativ që lidhet me paraqitjen, kthimin, mosprocedimin apo bllokimin e listëpagesave dhe urdhër-shpenzimeve.

Paditësi kërkon gjithashtu që, nëse gjykata e çmon të nevojshme, t'i kërkohej Ministrisë së Financave paraqitja e **të gjithë praktikës administrative të “verifikimit”** të cilit i referohet në shkresën e saj, përfshirë urdhrat, porositë, komunikimet e brendshme, opinionet juridike dhe financiare dhe çdo akt mbi bazën e të cilit strukturave të Thesarit u është komunikuar të mos procedojnë dokumentacionin financiar të paraqitur.

PADITËS
GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Përfaqësuar me autorizim nga Nëpunësi Autorizues

Kancelari Anila Kulo